



21-03-2022
02 / 133



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komisioni Komunal i Aksionarëve

Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve”, SH.A Malishevë në mbledhjen e mbajtur më 15.03.2022, në përputhje me nenin 16 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për “Ndërmarrjet Publike”, të datës 13 qershor 2008, shpall:

KONKURS

Pozita: **Drejtor në Bordin e Drejtorëve të NPK “Stacioni i Autobusëve”, SH.A. Malishevë**

Numri i Pozitave: **4 (katër)**

Kohëzgjatja e mandatit: **3 (tre) vjeçar**

Vendi i Punës: **Malishevë**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Të respektoj ligjet, statutin e Ndërmarrjes, aktet tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit Komunal në pajtueshmëri me ligjin.
- Përgatit dhe miraton strategjinë afatgjate, poashtu miraton Planin e Punës, Raportin e punës dhe atë financiar.
- Emëron, largon apo zëvendëson Kryeshefin Ekzekutiv.
- Kryen mbikqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi punën e biznesit të ndërmarrjes, mbi punën e Kryeshefit Ekzekutiv dhe zyrtarëve tjerë brenda ndërmarrjes.
- Siguron që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat janë në nivelin e duhur.
- Për punën e vet Bordi i Drejtorëve i përgjigjet Komisionit të Aksionarëve dhe Kuvendit Komunal.

KUALIFIKIMET DHE AFTËSITË:

Kandidatët e suksesshëm për pozitën e Anëtarit të Bordit të Ndërmarrjes Publike Komunale duhet të plotësojnë kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe përshtatshmërisë profesionale, si vijon:

- Diploma e fakultetit dhe trajnime tjera relevante.
- Rekomandohet përvoja e punës
- Të jetë person me integritet të dëshmuar i cili plotëson kushtet e parapara me dispozitat e nenit 17.1, 17.2, 17.3, 17.4 dhe 17.4a, të Ligjit nr. 03/L-87, për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht Ligjit mbi ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 si dhe me Ligjin nr. 05/L-009.
- Njohuria e gjuhëve të huaja dhe e punës me kompjuter do të konsiderohen përparësi.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

- Me Intervistë

KUSHTET TJERA:

Kandidatët për Drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Komunale “Stacioni i Autousëve”, SLLA, në Malishevë, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letërmotivimin
- Diplomën e përgatitjes shkollore
- Dëshminë për përvojën e punës
- Deklaratën nën betim në të cilën deklaron ai/ajo se i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafit 1-3 të nenit 17, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike(formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën që dëshmon se nuk është nën hetime për vepra penale dhe civile sipas nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike
- Kopje të Letërnjoftimit ose Pasaportës së Republikës së Kosovës (që dëshmon se është shtetas i Republikës së Kosovës)

DORËZIMI I APLIKACIONIT:

- Dokumentacioni duhet të jetë në pliko të mbyllur, ku shkruhet. Emri dhe Mbiemri i aplikantit, emri i NPK-së dhe të dorëzohet pranë zyrave të NPK “Stacioni i Autobusëve”, SH.A. Malishevë, rruga “Adem Jashari”, (përballë Stacionit të Policisë).
- Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Dokumentet origjinale mund të kërkohen gjatë intervistës.
- Aplikacionet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të merren në shqyrtim nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Do të kontaktohen vetëm personat e përzgjedhur për intervistë.

KOMPENSIMI I DREJTORËVE TË BORDIT:

Kompensimi i Drejtorëve të Bordit të NPK “Stacioni i Autobusëve”, SH.A. bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087, për Ndërmarrjet Publike.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes e-mailit: komuna.malisheve@rks-gov.net

Afati i Konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit.

Malishevë, 21 mars 2022

Kryesues i Komisionit Komunal të Aksionarëve:

Jahir Xhyliqi